



Planuar / Dorezuar Prijmjen/Prodato Received/Delivered	01-08	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Hr Prot Br Prot Prot.No	Shtjela Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SRMSHCK	5978	2023	114



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.852/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Sabile Avdyli, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, sipas ankesës me numër A.nr.852/2023 të datës 15.06.2023 të parashtruar nga ankuesi/

dhe kundër organit të punësimit Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.07.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të shqyrtoj kërkesat e ankuesve të datës 05.04.2023, 10.05.2023 dhe 02.06.2023, lidhur me kompensimin për funksione shtese si dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësit civil dhe të punësuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe të punësuar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me datë 15.06.2023 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të mos kompensimit të pagës për funksione shtesë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit

Lokal, lidhur me punën në Komisionin Ndërinstitucional për Verifikimin e Respektimit të të Drejtave dhe Interesave të Qytetarëve të Komunës së Graçanicës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 22.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa kjo e fundit më datë 27.06.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4784/2023 të datës 15.06.2023 të parashtruar nga grup ankuesish në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; E-maili i datës 03.04.2023 nga ankuesi për Ministrinë e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal; E-maili i datës 25.04.2023 nga ankuesi për Udhëheqësen e Burimeve Njerëzore; E-maili i datës 09.06.2023 nga ankuesi për Zv.Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal; Kërkesën për kompensim e datës 13.04.2023 nga Kryesuesi i Komisionit për verifikimin e respektimit të drejtave dhe interesave të qytetarëve të Komunës së Graçanicës për Sekretarin e Përgjithshëm në MAPL; Vendimi me numër protokollit 020-219/5 të datës 23.03.2023 i lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së; kopja e letërnjoftimit; kartela e bankës; kopja e letërnjoftimit dhe kartela e bankës për N.H; E-maili i datës 23.03.2023 nga zyrtarja e MPB për ankuesin; E-maili i datës 03.04.2023 nga zyrtari i Agjencionit Kadastral të Kosovës për Kryesuesin e Komisionit për verifikimin e respektimit të drejtave dhe interesave të qytetarëve të Komunës së Graçanicës; E-maili i datës 27.03.2023 nga Kryesuesi i Komisionit për anëtarët e komisionit; E-maili i datës 24.03.2023 nga zyrtarja e MMPHI për Kryesuesin e Komisionit; Kopja e letërnjoftimit dhe kartela e bankës për A.D; Kopja e letërnjoftimit dhe kartela e bankës për N.N; Raporti lidhur me takimet e realizuara nga Komisioni për verifikimin e respektimit të drejtave dhe interesave të qytetarëve të Komunës së Graçanicës; Kërkesën në përgjigje në ankesë e datës 22.06.2023 për organin e punësimit nga Këshilli; Përgjigjen në ankesë e datës 27.06.2023 nga organi i punësimit për Këshillin bashkë me shkresat e lëndës si: Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit për ankuesin i datës 29.03.2019; Vendimi me numër protokollit 020-219/2 i datës 16.03.2023 i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal; vendimi me numër protokollit 020-219/2 i datës 16.03.2023 i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të emërimit për ankuesin i datës 13.11.2013; Akt emërimi me numër protokollit 13/2019 i datës 02.10.2019 për ankuesin Akt emërimi me numër protokollit 01/128/10 i datës 29.01.2019 për ankuesin Akt emërimi i datës 16.12.2013 për ankuesin Akt emërimi i datës 01.06.2015 për ankuesin Akt emërimi i datës 24.04.2017 për ankuesin dhe Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtar për hulumtim i datës 26.01.2017.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të shkresave të lëndës, konstatoi që lënda të kthehet në shqyrtim të organi i punësimit, me obligimin që Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, të shqyrtoj kërkesat e ankuesve lidhur me kompensimin për funksione shtese si objekt i kësaj ankesë, *sepse:*



Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Pushtet Lokal dhe së i njëjti sipas Aktit të Emërimit nr.prot:131/2019 të datës 02.10.2019 ushtron pozitën e punës Zyrtar i Lartë Ligjor, ankuesi është i punësuar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, rrejdhimisht i njëjti sipas Aktit të Emërimit me numër protokolli 01/128/19 të datës 29.01.2019 ushtron pozitën e punës Zyrtar i Lartë Ligjor, ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë dhe se i njëjti sipas Aktit të emërimit të datës 01.06.2015 ushtron pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit të RDPP&SIKTK, ankuesi është i punësuar në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisin dhe së i njëjti sipas Aktit të Emërimit të datës 24.04.2017 ushtron pozitën e punës Zyrtar për Hulumtim, ndërsa ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe si njëjti sipas Aktit të Emërimit të datës 29.02.2019 ushtron pozitën e punës Zyrtar i Lartë Koordinues Ndërkufitar.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton së Ministri i MAPL-së me Vendimin më numër protokolli 020-219/2 të datës 16.03.2023 ka themeluar Komisionin për Verifikimin e Respektimit të të Drejtave dhe Interesave të Qytetareve në Komunën e Graçanicës, ndërsa me Vendimin me numër protokolli 020-129/5 të datës 23.03.2023 të Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së, është bërë emërimi i përfaqësimit të anëtareve të këtij komisioni në përbërje nga; përfaqësues nga MAPL të autorizuar kryesues dhe anëtar; 2. përfaqësues nga MPB, i autorizuar 3.përfaqësues nga MMPHI, i autorizuar 4. Përfaqësues nga Agjencia Kadastrale e Kosovës të autorizuar dhe

Sipas sqarimeve në ankesë Komisionin për Verifikimin e Respektimit të të Drejtave dhe Interesave të Qytetareve në Komunën e Graçanicës, i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së për kompensimin e funksionit shtesë lidhur me punët në këtë komision dhe atë për muajin mars, prill maj dhe qershor 2023, mirëpo që vetëm për muajin mars është aprovuar kërkesa për kompensim mirëpo që asnjëherë nuk kishte marr përgjigje lidhur me kërkesat e datës 05.04.2023, 10.05.2023 dhe 02.06.2023.

Kolegji i Këshillit iu referua dispozitave e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 83 *Procedura administrative fillon sipas kërkesës të palës apo sipas detyrës zyrtare nga organi publik*, Nenit 97 paragrafi 1 më të cilin parashihet se: *Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative*, si dhe nenin 98 ku thuhet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj.* 3. *Nëse me ligj parashihet detyrimi i palës për të parashtruar një dokument apo për të kryer një veprim procedural, si pjesë apo së bashku me parashtrimin e kërkesës për fillimin e procedurës, afati i përcaktuar në pajtim me paragrafin 1 ose 2 të këtij neni, do të fillojë të llogaritet nga parashtrimi i dokumentit apo kryerja e veprimit procedural përkatës”,* nisur nga ky përcaktim ligjor dhe duke qenë së organi i punësimit në këtë rast Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk ka shqyrtuar kërkesat e ankuesve lidhur me kompensimin për funksion shtesë përkitazi me angazhimin në Komisionin për Verifikimin e Respektimit të të Drejtave dhe Interesave të Qytetareve në Komunën e Graçanicës, rrjedhë detyrimi që Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të shqyrtoj kërkesat e ankuesve për kompensim, të parashtruara me datë 05.04.2023, 10.05.2023 dhe 02.06.2023 dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim më

dispozitat ligjore në fuqi dhe të njëjtin t'ia komunikoj palës ankuese siç përcaktohet me nenin 118 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, e në kuptim të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.852/2023

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-DEMI
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesve
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së